



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 7901 Prot.

Tiranë, më 3/06/2016

Drejtuar: Z. ENGJËLL AGAÇI
Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.1, Tiranë

Subjekti: Dërgohet për shqyrtim dhe miratim një projektvendim

I nderuar z.Agaçi,

Bashkëlidhur, Ju lutemi gjeni për shqyrtim dhe miratim projektvendimin "Për shpërndarjen pjesore të të ardhurave nga privatizimi i shoqërisë 'INSIG' sh.a.", si dhe relacionin shoqërues të tij.

Me respekt,

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, Datë _____ 2016

“PËR

**SHPËRNDARJEN PJESORE TË TË ARDHURAVE NGA
PRIVATIZIMI I SHOQËRISË “INSIG SH.A””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 9, të ligjit nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave;

V E N D O S I:

1. Kufiri i shpenzimeve kapitale dhe niveli i deficitit buxhetor, miratuar në ligjin nr.147/2015, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, shtohet me 1 100 000 000 (një miliard e njëqind milionë) lekë nga të ardhurat e realizuara nga privatizimi i shoqërisë “INSIG sh.a”.
2. Fondi prej 1 100 000 000 (një miliard e njëqind milionë) lekë i shtohet kufirit të shpenzimeve kapitale të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, në programin “Transporti Rrugor”, për projektin “Ndërtim rruge Unaza e Re e Tiranës (segmenti Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës) Loti 1”.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

RELACION SHPJEGUES PËR PROJEKTVENDIMIN

“PËR

SHPERNDARJEN PJESORE TË TË ARDHURAVE NGA PRIVATIZIMI I SHOQËRISË “INSIG SH.A”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet avancimi i financimit për projektin “Ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës (segmenti Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës) Loti 1”, duke qënë se realizimi faktik i punimeve deri tani është 65% të volumit të kontratës dhe punimet janë ndërprerë për mungesë planifikimi financimi. Theksojmë se ky projekt ka një vlerë të madhe për qytetin e Tiranës për kalimin e trafikut të automjeteve për të hyrë në qytetin e Tiranës, rrugës së Elbasanit, drejt “21 Dhjetorit”, si zona shumë të populluara të kryeqytetit. Vazhdimi i punimeve dhe financimit për këtë segment do të krijonte kushtet për përfundimin e plotë të projektit brënda vitit 2016. Kjo do të bënte të mundur rehabilitimin e plotë të kësaj nyje të rëndësishme transporti dhe zone të qytetit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi i hartuar nuk është planifikuar në programin analitik të akteve dhe dokumenteve të tjera politike për vitin 2016 për Ministrinë e Financave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nëse kjo kontratë nuk financohet do të krijoheshin kosto shtesë financiare pasi të gjitha punimet e kryera deri tani si në strukturën beton arme të mbikalimit ashtu edhe në armaturën e hekurit, të cilat janë nën efektin e agjentëve atmosferikë do të mund të dëmtoheshin. Nga ana tjetër ndotja ambjentale është mjaft problematike pasi është hequr shtresa asfaltit si dhe lëvizja e ngadaltë e makinave krijon trafik dhe tymra në një shkallë të madhe. E cënuar është edhe siguria rrugore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti i propozuar është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 9 të ligjit 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016” .

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk përfron me ndonjë akt ligjor të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi parashikon rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale dhe deficitit buxhetor, miratuar në ligjin nr. 147/2015, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me 1 100 000 000 (një miliard e njëqind milionë) lekë për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, në programin “Transporti Rrugor”, për projektin “Ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës (segmenti Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës) Loti 1”. Sipas nenit 9 të ligjit nr. 147/2015, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2016, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër përdoret, me vendim të Këshillit të Ministrave, për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila, automatikisht, rrit kufirin e deficitit të Buxhetit të Shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji. Me VKM nr.218 datë 23.03.2016 “Për miratimin e procedurës së tenderimit për shitjen e paketës së aksioneve (100 %), të zotëruara nga shteti në shoqërinë “INSIG SH.A”, Tiranë” dhe shpalljen fitues të tenderit shoqërinë “EUROSIG SH.A”. Nga ana e Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike në Ministrinë e Financave, më datë 01.06.2016 u nënshkrua kontrata e shitblerjes së aksioneve me shoqërinë “EUROSIG SH.A”. Kontrata është nënshkruar pasi nga ana e blerësit është realizuar dhe konfirmuar pagesa e plotë e çmimit 2 222 122 000 (dy miliard e dyqind e njëzet e dy milion e njëqind e njëzet e dy mijë) lekë e ofruar në tender.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ky projekt ngarkon Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës të zbatojnë përcaktimet e këtij projektvendimi.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga Ministria e Financave, ka karakter individual dhe për këtë arsye nuk është dërguar për mendim paraprakisht në Ministrinë e Drejtësisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare të këtij projektvendimi janë 1 100 000 000 lekë në zërin investime. Efekti financiar i vlerës 1 100 000 000 lekë (një miliard e njëqind milionë) lekë do të përballohet nga të ardhurat pjesore të siguruara nga privatizimi i shoqërisë “INSIG SH.A”

MINISTRI I FINANCEVE

ARBEN AHMETAJ

